



GJYKATA THEMELORE PEJE 6596/19
11:13

Republika e Kosovës
Republika Kosovo/ Republic of Kosovo
Prokurori i Shtetit / Državni Tužilac / State Prosecutor
PROKURORIA THEMELORE PEJË/ OSNOVNO TUŽILAŠTVO PEÇ/ BASIC PROSECUTION PEJA

PP/I nr. 89/18

Pej; m; 12.06.2019

GJYKATËS THEMELORE
DEPARTAMENTIT TË KRIMEVE TË RËNDA

PEJË

Konform nenit 241, 242, të KPP-ës ngris:

A K T A K U Z Ë

Kundër:

1. **SHABAN GOGAJ**, i biri i Halilit e Rayes e lindur Osdautaj, i lindur më 20.05.2000 në Deçan, ku dhe banon, rruga " Elena Gjikai" nr 12, i pamartuar, ka të kryer shkollën e mesme, student, i gjendjes së mirë ekonomike, me tel 044- 998-816, shqiptar, shtetas i Kosovës, **gjendet nën Masën e Paraburgimit, të Caktuar me Aktvendim të Gjykatës Themelore në Pejë, nën DKR PP nr.74/18, të dt. 25.09.2018, që nga dt. 23.09.2018, i cili mund të zgjas gjerë më dt.19.06.2019 në ora 13:00**

2. **ISUF CACAJ** i biri i Shabanit dhe i Nushes e gjinisë Mulaj, i lindur më datë 11.07.1976, në Deçan, ku dhe banon, rruga "Elena Gjika" nr 8, ka të kryer shkollën e mesme, pronar i Kompanis "GOGAJ AG" me seli në Deçan, i martuar, baba i dy fëmijëve, me ID 1009515433 me tel. 044 118-788, shqiptar, shtetas i Kosovës

PËR SHKAK SE:

I Pandehuri: SHABAN GOGAJ

I- Me datë 23.09.2018, rreth orës 11.04 min, në Deçan, në rrugën "Luan Haradinaj" nr 130, në Kompaninë "Gogaj AG ", me dashje e privon nga jeta Agonis Tetaj nga fshati Llukë e Deçanit, dhe me këtë rast vë në rrezik jetën e këtu të dëmtuarëve. Azgon Hadërgjonaj dhe Faruk Zukaj, në atë mënyrë që pasi i pandehuri merr një telefonatë nga Natyra Melaj, këtu dëshmitare, nga e cila bisedë shifet se është dukshëm i acaruar, i dëmtuari Agonis menjëherë largohet në drejtim të stogjeve përballë tij, në distancë prej rreth 4.70m kështu veprojn edhe të dëmtuarit Azgon e Faruk, dhe posa e përfundon këtë bisedë, i pandehuri, nga karriga në skajin e anës së majtë të banakut, kalon në karrigen tjetër që gjendej në mes të banakut, lakohet dhe nxjerr nga sirtari i fundit në anën e djathtë të tijë revolen e tipit "Beretta", model 92, FS, vendosë karikatorin dhe e repeton të njejtën, e merr në shenjë të dëmtuarin Agonis, i cili në ato momente ishte në mes të të dëmtuarve Azgon e Faruk, pothuajse ngjitur me ta, qëllon një herë në drejtim të tij dhe e kthen armën ku e kishte marr dhe menjëher ngritet nga karriga, për pasojë i dëmtuari merr plagë në kokë, konkretisht në mollëzën e djathtë të fëtyrës, duke depërtuar kështu predha nëpër kockën zigomatike (mollëzën e fëtyrës), kalon nëpër nofullën e sipërme të djathtë, vazhdon nëpër indet e buta të qafës dhe nën bazën e kafkes, duke përfunduar në pjesën e pasme të qafës, mu në mesin e saj si vrimë dalëse, me ç`rast shkaktohet gjakderdhja e jashtme dhe gjakderdhja në cipat e buta të trurit dhe të trurit të vogël, si rrjedhojë i dëmtuari Agonis pëson vdekje të menjëhershme.

-me çka ka kryer vepër penale-Vrasje e rëndë nga neni 179, par.1, nënpar.1.5 të KPRK-ës

II. Me datë 23.09.2018 rreth orës 11.04 min, në Deçan në rrugën "Luan Haradinaj" nr 130, në Kompaninë "Gogaj AG ", në kundërshtim me Ligjin për armë ka mbajtur në posedim armën, dhe atë revolen e tipit Beretta, model 92, FS, kalibër 9 mm me nr serik BER.706093, një karikatorë të të njëjtës armë dhe njëmbëdhjetë (11) fishek, në atë mënyrë që me rastin e kontrollit nga policia në sirtarët nën banakun e kasës, që gjendeshin në krahun e djathtë është gjetë dhe sekuestruar arma në fjalë, për të cilën është konstatuar se i pandehuri nuk ka leje të organeve kompetente.

-me çka ka kryer vepër penale-Mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par 1 të KPRK-ës

I Pandehuri: ISUF CACAJ

Me datë 23.09.2018, rreth orës 14: 50, në Deçan në shitoren "GOGAJ AG", ka mbajtur në pronësi armë në shkelje me ligjin e zbatueshëm lidhur me armët e tilla dhe atë Pistoletën e tipit Blow TR 92 e kalibrit 9 mm, 15 – 1306191, një karikator dhe një fishek, në atë mënyrë që me rastin e kontrollit nga policia në sirtarët nën banakun e kasës, që gjendeshin në krahun e djathtë është gjetë dhe sekuestruar arma në fjalë, për të cilën është konstatuar se i pandehuri nuk ka leje të organeve kompetente.

me çka ka kryer veprë penale - mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par 1 të

A n d a j

PROPOZIM:

Që gjykata pas shqyrtimit të parë dhe të dytë, konform nenit 245 e 254 të KPP-ës ta aprovoj Akuzën dhe ta caktoj shqyrtimin kryesor verbal-publik, ku të ftohen:

- **Prokurori i Shtetit i Prokuroris Themelore–Departamenti i Krimeve të Rënda në Pejë,**
- **I pandehurit:**
 1. **Shaban Gogaj** –në adresë të siërshënuar, së bashku me mbrojtësin me autorizim Besnik Berisha, av nga Prishtina
 2. **Isuf Cacaj** –në adresën e sipërshënuar
- **Të dëmtuarit:**
 1. **Isuf Tetaj** - nga fshati Llukë e Ulët, K Deçan
 2. **Nuriye Tetaj** - nga fshati Llukë e Ulët, K Deçan
 3. **Albesa Cacaj** - nga fshati Llukë e Ulët, K Deçan, së bashku me përfaqësuesen e të dëmtuarve, Lule Bilalli Ymeri, av nga Prishtina
 4. **Azgon Hadërgjonaj** – nga fshati Sllupë, K Deçan
 5. **Faruk Zukaj** – nga fshati Beleg, K Deçan
- **Dëshmitarët:**
 1. **Dionis Tetaj** - nga fshati Llukë e Ulët, K Deçan
 2. **Selmon Tetaj** - nga fshati Llukë e Ulët, K Deçan
 3. **Florentina Melaj** - nga fshati Isniq, K Deçan
 4. **Natyra Melaj** - nga fshati Isniq, K Deçan

5. **Ngadhnjim Gjikota** - nga Deçani, Rr. 'E Demonstrave', Nr.12
6. **Zeqë Tishukaj** – nga Isniqi, K Deçan

Konform nenit 374/3 të KPRK-ës, Të Konfiskohen

- a.Një /1/ revole e tipit Beretta, model 92, FS, kalibër 9 mm me nr serik BER.706093, një karikatorë të të njëjtës armë dhe njëmbëdhjetë (11) fishek, si dhe
- b.Një /1/pistoletë e llojit BLOW, me nr serik TR 92, të cilat gjinden në Zingjirin e ruajtjes në Drejtorin Rajonale të Policis në Pejë- HRP-ë



Të bëhet administrimi i ketyre provave, që janë nën numra rëndor:

/FOLDERI I

Kallëzimi penal i SHR Pejë nr 2018- DC-338,2018- HRP-120, i faqe 1) dt.24.09.2018/

1. Fllesh Raport nr.2018-DC-338, i dt.23.09.2018
2. Raport i policit i dt 23.09.2018
3. Shënim zyrtar nr.2018-DC-338, i dt 23.09.2018
4. Raport njoftues i dt 24.09.2018, nr.2018-DC-338
5. Raport i policit hetues nga vendi i ngjarjes i dt 23.09.2018, i rreshterit Riza Mahaj
6. Raport policor hetues i dt 23.09.2018, i het.Imer Hylaj
7. Raport policor hetues i dt 24.09.2018, i het.Imer Hylaj
8. Deklarata e të dyshuarit Shaban Gogaj dhënë në polici me dt 23.09.2018
9. Deklarata e dëshmitarit Zeq Tishukaj e dt 23.09.2018
10. Deklarata e të dëshmitarit Ngadhnjim Gjikota dhënë në polici me dt 23.09.2018
11. Ajo e Azgon Hadërgjonaj me po të njëjtën datë.
12. Florentina Melaj me po të njëjtën datë dhënë në polici
13. Vërtetim mbi konfiskim 2018-DC-338 e dt 23.09.2018, të armës së llojit 'BERETTA'
14. ***2/dy/ CD -1 nga vendi i ngjarjes, si dhe 1 nga pamja e jashtme e objektit të Kompanis 'GOGAJ AG', në Deçan i ditës kritike***

Plotësim i kallëzimit penal me po të njëjtin numër i datës 25.09.2018

15. Fotodokumentacion i SMS-ve nga telefoni i Natyra Melaj
16. Deklaratë e dëshmitarit Natyra Melaj dhënë në polici me dt 25.09.2018
17. Vërtetim mbi konfiskim i dt 24.09.2018 të telefonit me nr.044/998-816 i të pandehurit
18. Raport i policit hetues Imer Hylej i dt 25.09.2018-I
19. Raport i policit Imer Hylej i dt 25.09.2018-II
20. Lista e dëshmimeve e dt 23.09.2018 nr.2018-DC-338 i 2 telefonave të llojit 'IPHONE' i të pandehurit dhe Samsung i viktimës Agonis Tetaj dhe

21. Egzamini i vendit të ngjarjes nga Njësi i Forenzikës së Krim Teknikës, DRP në Pejë, NR. TKRP 18/102 së bashku me Fotoalbum i dt 23.09.2018

Plotësim i kallëzimit penal i dt.03.10.2018.

- 22. Raport i policit hetues Imer Hylaj i dt 01.10.2018
- 23. Raport i policit hetues Imer Hylaj i dt 25.09.2018
- 24. Vërtetim mbi konfiskim i dt 01.10.2018 i 1 telefoni Samsung dhe karteles 045/723-004
- 25. Raport mjekësor për vdekje në emër të Agonis Tetaj me nr.19623 i dt.23.09.2018
- 26. Raport i këqyrjes së vendit të ngjarjes i dt 23.09.2018 TKRP nr 18/102.
- 27. Lista e dëshmimeve e dt 24.09.2019 – mostrat e marr nga i pandehuri, pistoleta e lloit BERETTA, predhë e fishekut, gëzhojë me mbishkrim të stampuar SUMBRO

Plotësim i kallëzimit penal me po të njëjtin numër i dt.04.10.2018

- 28. Raporti i hetuesit i dt 04.10.2018 – Imer Hylaj - #4217
- 29. Lista e dëshmimeve e dt 24.09.2018 - Një IPHONE – 35940608308615- 044 - 998-816 – pronë e Shaban Gogaj Telefon Samsung – 045/723-004 i viktimës Agonis Tetaj

Plotësim i kallëzimit penal me po të njëjtin numër i datës .09.10.2018,

- 30. Deklarata e dëshmitarit Faruk Zukaj e dt 08.10.2018 dhënë në polici
- 31. Deklarata e dëshmitarit Leonard Hylaj e dt 08.10.2018 – në polici
- 32. Raport i ekspertizës balistike- dt 21.11.2018..AKF/-2018-3096/2018-3062
- 33. Fotodokumentacion – arma – leje për armë shenjëtarie – Isuf Cacaj

Plotësim i kallëzimit penal me po të njëjtin numër i dt. 31.10.2018

- 34. Raport i policit hetues i dt 30.10.2018 – Imer Hylaj
- 35. Raport i policit hetues Imer Hylaj i dt 18.10.2018 me Fotoalbum
- 36. Raport i ekspertimit balistik i dt.12.11.2018.- AKF/2018-3096/2018-3061
- 37. Raport i ekspertimit balistik i dt. 07.11.2018 - AKF/2018- 0322 -mbetjeve te barotit).

Plotësim i kallëzimit penal me po të njëjtin numër i datës 16.11.2018.

(shkresat e përsëritura) sikur më lartë
Urdhëresa e prokurorisë e dt 24.10.2018

Plotësim i kallëzimit penal me po të njëjtin numër i dt. 29.11.2018

Kallëzim penal i Stacionit Policor Deçan nr.2018- DC-339, RF-2018-HRP-123 i dt.17.10.2018. në emër të Isuf Cacaj

- 38. Raporti fillestar i incidentit i dt. 23.09.2018
- 39. Flesh raport i dt 23.09.2018 2018-DC-339
- 40. Shënim zyrtar i dt 23.09.2018 – 2018-DC-339 – hetuesi Tahir Mazrekaj, #9172

- 41. Raport i policit hetues Imer Hylaj, i dt 08.10.2018 – 2018-HRP-123
- 42. Deklarata e të dyshuarit Isuf Cacaj e dt 16.10.2018 – 2018 – HRP – 123
- 43. Fotodokumentacion
- 44. Lista e dëshmimeve e dt 23.09.2018, Pistoletë me gaz **Blow TR**
- 45. Një karriaktor i pistoletës, një fishek, një çant për paketimin e armës, të mbledhura nga hetuesi Tahir Mazrekaj
- 46. Leje e veçant e armës – Isuf Cacaj DC 142201510515378

Plotësim i kallëzimit penal me po të njëjtin numër i datës 17.10.2018.

- 47. Raporti i policit hetues – Imer Hylaj i dt 12.10.2018 – nr 2018-HRP-120
- 48. Deklarata e dëshmitarit Halit Cacaj dhënë në polici me dt 16.10.2018 Ref 2018-HRP-120
- 49. Deklarata e të dyshuarit Isuf Cacaj i dt 16.10.2018 me po të njëjtin numër
- 50. Leje e veçant e armës nga MPB - RK- nr DC142201510515378

Plotesim i kallëzimit penal i dt.16.11.2018

Urdhërsa e prokurorisë

- 51. Raporti i ekspertimit AKF 2018/3096/2018-3061 i dt 12.11.2018
- 52. Raçport i ekspertimit i dt 07.11.2018 nga AKF/2018-03/22 i dt 07.11.2018

Plotesim i kallëzimit penal i dt.24.12.2018

- 53. Analiza e raportit të ekspertizës e dt. 24.12.2018 e hetuesit Imer Hylaj
- 54. Raporti i ekspertizës 195- FVTI-2018 I dt.19.10.2018. e Sektorit për Fotografi, Videoanalizë dhe Egzaminime të TI-së
- 55. Lista e dëshmimeve e dt 23.09.2018, Një IPHONE nr karteles 044-998-816 në emër të Shaban Gogajt
- 56. Një teelefon SAMSUNG nr 045-723-004 në emër të viktimës Agoni Tetaj.
- 57. 1 CD- 2018-DC0-338, 2018 HRP-120 nga Analiza e telefonave

Plotësim i kallëzimit penal me po të njëjtin nr. i dt. 17.01.2019 –

- 58. Foto Album i Autopsisë.

FOLDERI II

Aktvendim për Fillim të Hetimeve të dt.20.01.2016.

Kërkesë për caktimin e Paraburgimit i dt.08.05.2018.

Akt për zgjerim të hetimeve të dt. 17.01.2017.

Procesverbal nga seanca e dëgjimit për paraburgim i po të njëjtës datë.

Procesverbalet mbi dëgjimin e dëshmitarëve dhe të pandehurve në prokurori

- 59. dëshmitares Albesa Cacaj e dt 08./10.2018
- 60. dëshmitarit Dionis Tetaj e dt 06.10.2018
- 61. dëshmitarit Isuf Tetaj,
- 62. dëshmitares Nurije Tetaj
- 63. dëshmitarit Selmon Tetaj e dt 09.10.2018, në prokurori
- 64. dëshmitarit Ngadhjim Gjokokaj e dt 09.10.2018

- 65.dëshmitarit Azgon Hadërgjonaje dt 15.10.2018 ,
- 66.dëshmitarit Faruk ZUKaj dt 15.10.2018
- 67.dëshmitarit Florentima Melaj e dt 15.10.2018,
- 68.dëshmitarit Zeqë Tishukaj i dt 17.12..2018
- 69.dëshmitarit - Dr spec, Muhamet Halitaj i dt 17.12..2018
- 70.Procesverbal mbi marrjen në pyetje e të pandehurit Shaban Gogaj me dt 14.12.2018, si dhe ajo e dt.02.04.2019
- 71.Procesverbal mbi marrjen në pyetje e të pandehurit Isuf Cacaj me dt 14.12.2018
- 72.Raport i Autopsisë MA18 -203 i Mjekësisë ligjore në emër të viktimës Agonis Tetaj - nga Departamenti i Mjekësis Ligjore në Prishtinë
- 73.Raport i Ekzaminim psikiatrik i Institutit të Psikiatrisë Forenzike i dt 01.03.2019 – mbi gjendjen e shëndetit mendor për Shaban Gogaj - këtu i pandehur
- 74.Përgjigje në urdhëresën e Prokuroirsë nga AKF –Departamentit i Traseologjis Forenzike me nr Ref. AKF/2019 – 72, i dt.11.04.2019, lidhur me veprimet e të pandehurit Shaban me armën ditën kritike
- 75.Nga e kaluara kriminele -Propozim për shqiptimin e Masës Edukative për Shaban Gogaj– kopje- PPM 10/2018, e dt 16.02.2018



Së pari të sigurohet, e pastaj të lexohet raporti i kriminalistikës mbi denueshmerinë apo jo denueshmerinë e të pandehurit, si dhe certifikata mbi gjendjen ekonomiko-familjare të të njëjtit

Pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor, i pandehuri të shpallet fajtor të dënohet sipas ligjit si dhe të obligohet në paguarjën e shpenzimeve procedurale.

A r s y e t i m

DRP - Njësi i Hetimeve Regjionale - Pejë ka parashtuar Kallxim penal në këtë Prokurorime nr të rastit 2018- DC-338, Ref 2018 –HRP- 120, me datë 24.09.2018, si dhe 2018-DC-339 Ref 2018-HRP-123 e dt. 17.10.2018, kundër Shaban Gogaj etj, nga Deçani, me të dhëna sikur në dispozitiv, me dyshim se i njëjti ka kryer vepër penale - Vrasje së rëndë, nga neni 179 par 1 nënpar 1.5 si dhe vepër penale mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par 1 të KPRK-ës

-/-

✓ Prokuroria ka Filluar hetimet zyrtare me dt. 25.09.2018, nën PP/I nr.89/18 kundër të pandehurit Shaban Gogaj për veprat penale në fjalë dhe ka Zgjeruar hetimet edhe kundër të pandehurit Isuf Cacaj për vepër penale mbajtja në pronësi, kontroll apo posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par 1 të KPRK-ës me dt. 18.10.2018, ku janë siguruar prova, egzaminime e ekspertiza të shumta, janë dëgjuar të dëmtuar, dëshmitar, si dhe të pandehurit në fjalë.



Provat të cilat mbështesin pohimet e Aktakuzës:

Dëshmit personale

a) **Isuf Tetaj** – përndryshe babai i të dëmtuarit, tani të ndjerit Agonis Tetaj deklaron se Agonisi ka qenë shumë i sjellshëm, punën e ka dashur shumë si dhe shoqërin e shokët e punës, ka punuar shumë, të pandehurin thotë se nuk e njef, por se pas rastit ka dëgjuar se *i njejt i është problematik*, duke shtuar se familja e të njejtit kanë kërkuar t' i falin sepse ka ndodhur aksidentalisht, nëpërmjet grupeve të shumta të njerëzve, duke ofruar dy banesa, dhe për gruan e Agonisit pagë deri në moshën 65 vjet, por këta kanë reaguar dhe ata janë tërhequr

b) **Nurije Tetaj** – nëna e të ndjerit Agonis, deklaron se Agonisi kohëve të fundit, diku 2-3 javë para rastit, nga një djalë i hareshëm dhe i pakursyer në punë, dhe ate edhe kur ka qenë në pushim, është marr me krejt problemet në punë, është shëndrruar në person të heshtur, është tërhequr në vete vete, flinte gjatë kohës që ishte në shtëpi, dhe kur e njejt ka insistuar që t' i tregoj për problemin që po e mundon, ai i ishte përgjigjur *du me lshu punën, du me shku te Nisi* (sq. fjala është për vëllaun e tij Dionisin në Gjermani), prej se i kishte ndryshuar komplet sjelljet, nuk rrinte fare në shtëpi, dilte gjatë gjithë kohës, shton se gjatë kësaj kohe ta ketë dëgjuar të njejtin duke folur për Shabanin, se *është shumë i lazdruar dhe se po ju banë shumë presion punëtorëve*, dhe ka vretje nga që prej se e kanë varrosur djalin, familja Gogaj po ushtron presion të padurueshëm mbi ta, duke kërkuar nga ajo e baba i Agonisit t' i shohin kamerat, ku është regjistruar momenti i vrasjes.

c) **Albesa Cacaj** – bashkëshortja e Agonisit pranon se familjen Gogaj i ka kushëri të largët, të pandehurin Shaban e njef, por se nuk i ka rastisë që të rrij në shoqëri me te, vetëm e ka njohur si djaë të pronarit ku ka punuar Agonisi dhe nga ky i fundit ka dëgjuar të thotë për Shabanin se sillet superior ndaj punëtorëve dhe ka dëshirë të japë urdhëra, e jo babai i tij si pronar, duke shtuar se nuk është në dijeni të ndonjë problemi mes të ndjerit dhe të pandehurit, por se Agonisi ka qenë tip shumë i përkushtuar në punë, i pakursyer e edhe se ka pasur shumë raste që jashtë orarit, ai është marr me të gjitha problemet në punë.

d) **Azgon Hadërgjonaj** – punëtor në në Kompaninë "Gogaj AG " në Deçan, thotë ta ketë njohur viktimën që nga shkolla fillore pasi kanë qenë në një gjeneratë, por se me te nuk ka pasur shoqëri të afërt, për sjelljet e djalit të pronarit këtu të pandehurit Shaban dhe ndonjë problemi me Agonisin nuk është në dijeni, pasi ai punon vetëm si shofer në këtë kompani, ditën kritike ka qenë në afërsi të madhe me Agonisin, deri sa po qëndronin në këmbë, rreth 3m nga banaku i kasës kur ka dëgjuar një krismë dhe ka ndierë erë baroti dhe e ka parë Agonisin që ka rënë në tokë dhe ka vërejtur një vrimë në anën e djathët të fëtyrës, afër gojës dhe se ka filluar t'i del gjak, nuk i kujtohet ta ketë parë Shabanin apo t'i ketë par diqka në dorë.

e) **Faruk Zukaj** – gjithashtu punëtor në Kompaninë "Gogaj AG " në Deçan, deklaron se të pandehurin e njef vetëm si i familjes Gogaj jo më tepër, me të dëmtuarin, tani të ndjerin Agonis ka pasur raporte të mira, por nuk ka pasur raporte të afërta shoqërore, se ai ka qenë i shkëlqyeshëm dhe i pazëvendësueshëm në punë i sjellshëm me të gjithë, e sa i përket ditës kritike, shton se deri sa po qëndronte afër Agonisit në këmbë, i cili ishte ballë për ballë me Azgonin, ka ndëgjuar një krismë dhe i është rrëzuar Agonisi para këmbëve, është afruar Ngadhënjimi dhe thonte `o bre kapene kapne..` më vonë ka dëgjuar se i pandehuri Shaban ka shtënë me armë, për raportet mes të pandehurit dhe të dëmtuarit nuk din, pasi që nuk ka qenë i afërt me viktimën

f) **Dionis Tetaj**- vëllau i viktimës deklaron se me Agonisin edhe nuk ka qenë shumë i afërt, për shkak të dallimit në moshë, sepse ai ka qenë më i madh se ky, të pandehurin e njef mirë edhe pse nuk ka pasur shoqëri me te, sa i përket raporteve mes këtij të fundit dhe Agonisit thotë se edhe pse nuk i ka folur Agonisi, ka qenë në dijeni se i pandehuri i ka bërë presion të madhë, dhe se ka pasur problem me krejt punëtorët, si dhe i kujtohet një rast kur edhe djali i axhës së Shabanit i kishte rënë shuplakë Agonisit, ka ndëgjuar se Shabani e ka therë me thikë një person, këtë e ka dëgjuar nga motra e tijë në Gjermani e cila i ka thënë se pas rastit, i ka shkruar një grua në faqet sociale , dhe atë`se `ky është ai djali që ma ka therr djalin me thikë në qafë dhe nuk kanë aerdhë as nuk me kanë vetë familja e tij për këtë rast`

g) **Selmon Tetaj** – djali i axhës së viktimës, i kujtohet se diku dy javë para se të ndodhë rasti, kur i kishte bërë problem i pandehuri, përshkak se ky gjatë një pagese i mungonte 1 euro, dhe pasi kishte ndërhyrë Agonisi, Shabani e ka, siq shprehet `prishë` fëtyrën dhe e ka ngritur dorën e djathët te një dollap nën kacë dhe deri sa luante kështu me dorë, t'i ketë thënë Agonisit: *`Goni ti e din çka kamë qetu`* `pasi kanë dalë së bashku jashtë lokalit, e ka pyetur Agonisin se *`kush ke ky djali që hiq nuk më pëlqej`*, Agonisi i është përgjigjur: *`djali i pronarit, osht djali i keq dhe po na bon shumë presion`*

...

h) **Florentina Melaj** - deklaron se të pandehurin e ka djalin e dajës, se punon si arkatare në Kompaninë "Gogaj AG " në Deçan, prej pesë vitesh, ditën kritike është ndërruar me Shabanin në kacë, rreth orës 11.05min, dhe ka kaluar pas tijë në krahun e majt një hapë, nuk i kujtohet a ka qenë në këmbë apo ulur kur ka dëgjuar një krismë dhe Shabani i ka thënë `e mbyta njerin..` dhe se e ka vërejtur Agonisin të

plagosur në faqe tuj ra në tokë, ka qenë në dijeni se ka qenë një armë në fiokën e fundit, shton se nuk i ka vërejtur veprimet e të pandehurit e as armë në dorë paraprakisht,

E pranon se ka dhënë deklaratë dhe nënshkruar në polici menjëherë pas rastit me dt.23.09.2018, në ora 15.15min, , e ballafaquar me këtë deklaratë nga ana e Prokuroris, me faqen e dytë, rreshtin e 13-të, ku thot: *(cit.)*, `..aty ishte edhe Shabani dhe pash se ai kishte në dorë një revole me ngjyrë të bardhë (bronze) e cila ishte pa karikator, Shabani posa e mori revolen në dorë dhe i njejtj brenda në banak te arka e raportirati aty armën dhe i njejtj e ka drejtu kahë punëtorët që ishin para arkës duke bërë hajgare.dhe duke folë për bjeshkë, në atë moment kamë dëgju një krismë të armës dhe pash Agonisin u rrëzua për tok`...

Pas këtij ballafaqimi, e njejtja e mohon, me arsyetim se i ka thënë policis që ta shlyej dhe ata t'i kenë thënë se e kanë shlyer...

i) **Natyrja Malaj** – e marr në pyetje nga policia me autorizim të Prokuroris, e në prezencën e prindit, me dt. 25.09.2018, deklaroi se të pandehurin e ka djal dajë dhe se me të njejtin ka biseduar me telefon pak momente para se të ndodhë rasti, kanë biseduar për dalje në Bjeshkë dhe gjërat ushqimore që duhet t'i marin me vete, ajo ka qenë në dijeni për ekzistimin e një arme në dollap me leje, por se në emër të kujt ka qenë, nuk e din

j) **Ngadhënjim Gjirkokaj** – punëtor në kompanin në fjalë, të ndjerin Agonis e ka pasur shok të ngusht, në firmë thotë se Agonisi i ka pasur raporte të mira me të pandehurin Shaban, e jashtë firme nuk e din çfar raportesh kanë pasur, ka qenë në dijeni nga shefat se ka një armë në kacë, por ky nuk e ka parë të njejtën, meqë qasje në kacë thotë të kenë pasur vetëm shefat e fëmijt e tyre, siq shprehet, ka qenë prezent ditën kritike, konkretisht te dera e lokalit kur ka dëgjuar një krismë dhe kur është kthyer ka parë Agonisin që ka ra në tokë, po ashtu shton se kur është dëgjuar krisma ka qenë jashtë derës së lokalit dhe nuk e ka parë Shabanin me armë apo kur ka shtënë.

k) **Zeqë Tishukaj** – po ashtu punëtor në kompanin në fjalë, deklaroi se ditën kritike deri sa po kthehej prej banjos ka dëgju një krismë e pastaj ka parë se çka ka ngjarë, më vonë ka kuptuar se Shabani ka shtënë me armë, nuk është në dijeni për ndonjë problem mes të pandehurit dhe të ndjerit, pasi sipas tij në firmë kanë qenë raportet e mira mes punëtorve, i ballafaquar me deklaratën në polici me dt.23.09.2018, ku deklaroi (cit) ``..në shkalla jamë taku me Shabanin i cili dilke nga shitorja, duke kukatë dhe tha më shkrepj arma..`, thot se nuk i kujtohet, duke shtuar se ka qenë në dijeni se në sirtar te kaca gjendet një armë, e jo dy, por se punëtorët nuk kanë guxuar të hyjnë në atë pjesë.

Deklaratat e të pandehurve:

A. Shaban Gogaj – përderi sa në polici mbrohet në heshtje, në Prokurori deklaroi se në Kompaninë "Gogaj AG ", e cila është pronë e familjes punon që nga mosha 10 vjeçare, të dëmtuarin, tani të ndjerin Agonis, i cili është punësuar rreth 5

vitesh para rastit në këtë Kompani e përshkruan si punëtor shumë të mirë dhe të hareshëm, me të njëjtin i kanë pasur raportet shumë të mira, me të cilin është shoqëruar në punë dhe jashtë pune, rreth ditës kritike, i kujtohet se ka qenë ditë e diele dhe ka dal në punë rreth orës 7.30min, kanë ba hajgare me punëtorët, me të cilët kanë planifikuar daljen në Bjeshkë, nuk i kujtohet saktësisht ora kur vajza e hallës e ka thirrë në telefon, Natyra Malaj, *nuk e din se çka ka biseduar me te*, vetëm thotë t'i ketë treguar e njëjta se gjendet te vendi i quajtur `Vorri i vajzës` pasi e ka përfunduar bisedën me te, e ka pyet Agonisin `a keni marr diçka me gjujtë atje..`, fjalën thotë ta ketë pasur për armë, armë me gazë...dhe ashtu tuj bisedu ..., *(cit.) ``e kamë marrë alltin me gaz që e kom në fijoshtë nën tavolinën e punës, ku osht kaca e kom drejtu veq kom gjujt me to, edhe kur e pava u rrëxu Agonisi edhe qekaq mo nuk di, më ka hupë kontrolla...`*, shton se nuk ka njohuri për armë, nuk i ka vizituar poligonet e qitjes, dy herë vetëm ka gjuajtur me armën me gazë, një herë në Bjeshkë e një herë për Vitin e ri, arma që është gjetë më von në sirtar e llojit BLOW, e e cila thot se i takon axhës së tij Isuf Cacaj, për armën e tipit Beretta, model 92, me të cilën është kryer vepra, thotë të mos ketë qenë në dijeni për të njëjtën se ka qenë aty, e që pas rastit ka kuptuar se edhe ajo i takon axhës Isuf, nuk është në dijeni për arsyen e ndryshimit të sjelljeve të Agonisit kohëve të fundit e as për rrethanën se i ndjeri është ankuar në sjelljet e tijë.

B. Isuf Cacaj – në Prokurori është mbrojtur në heshtje, për deri sa në polici me dt 16.10.2018, edhe pse deklaron se arma me gazë llojit BLOW që është gjetur në vend ngjarje është e tija, ai nuk e din kur e ka blerë saktësisht, ku e ka bler, nga kush e ka blerë, e as llojin apo tipin e sajë,

Provat materiale:

i. Nga Raportet e shumta policore, Shënimeve Zyrtare, Shiqimit të vendit të ngjarjes nga ana e Njësitit të Forenzikës të Drejtoris Rajonale të Policis në Pejë, nga ana e Krim Teknikës me nr. TKRP 18/102, e dt.23.09.2018, Vërtetime mbi sekuestrim të sendeve, të bashkangjitura Kallzimeve penale e Plotësimeve të kallzimeve penale, me nr të rastit 2018- DC-338, Ref 2018 –HRP- 120, si dhe 2018-DC-339 Ref 2018-HRP-123 – konstatohet se rasti ka ndodhur me dt. 23.09.2018, rreth orës 11.04 në Kompaninë "Gogaj AG", në Deçan, si dhe pasqyrohen të gjitha veprimet hetimore të ndërmarra me këtë rast, të përcjella me fotoalbume, egzaminime e ekspertiza të shumta të provave të siguruara në vend ngjarje

ii. Nga CD –et e vendit të ngjarjes së kamerave të vendosura në lokalin e Kompanis `GOGAJ AG-` në Deçan, - pasqyrohet momenti i kryerjes së veprës penale, me dt. 23.09.2018, rreth orës 11.04min, veprimet konkretisht të të pandehurit Shaban, viktimës Agonis, por edhe veprimet e policis menjëherë pas rastit, si dhe jashtë objektit, nga kamerat përballë

iii. Nga Ekspertiza Balistike AKF/2018-3096/2018-3062, i dt. 21.11.2018 – vërtetohet se pistoletë Pietro Beretta M92 FS, e kal.9x19, me nr. serik BIER 706093, me të cilën është kryer vepra është funksionale dhe se plumbi i nxjerr nga viktimë i takon kësaj pistolette, sikurse gëzhoja e gjetur në lokal ditën kritike

iv. **Nga Leja e veçant e armës –DC 142201510515378** - vërtetohet se për armën me të cilën është kryer vepra, evidentohet në emër të Isuf Cacaj **si dhe fotoja e armës në fjalë**

v. **Nga Raporti fillestar i incidentit** i dt. 23.09.2018, Flesh raport i dt 23.09.2018 2018-DC-339, Shënim zyrtar i dt 23.09.2018 – 2018-DC-339 – hetuesi Tahir Mazrekaj, #9172, Raport i policit hetues Imer Hylaj, i dt 08.10.2018 – 2018-HRP-123, Deklarata e të dyshuarit Isuf Cacaj e dt 16.10.2018 – 2018 – HRP – 123, Fotodokumentacion, Lista e dëshmitëve e dt 23.09.2018, Pistoletë me gaz Blow TR, Një karriktor i pistoletës, një fishek, një çant për paketimin e armës, të mbledhura nga hetuesi Tahir Mazrekaj – vërtetohet se i pandehuri Isuf Cacaj ka mbajtur në pronësi pistoletën në fjalë, pa leje të organeve kompetente

i. **Nga sequencat e nxjerra nga video inçizimet e vendit të ngjarjes dhe analizimi i tyre**

Vërtetohet se policia e Stacionit Policor në Deçan kryesisht nuk e ka bërë sigurimin e vendit të ngjarjes menjëherë pas rastit, siq kërkohet me rregullat e kriminalistikës, për më tepër, në vendin ku është gjetur arma me të cilën është kryer vepra, kanë pasur qasje persona të ndryshëm civil, familjar si dhe polic të patrollës e hetues, të cilët kanë hapur sirtarët nën banak, se çka kanë nxjerr apo futur, kamerat nuk e kapin atë pjesë fatkeqësisht, dhe kjo ka ndodhur ende pa arritur Njësiti i Forenzikës së Krim Teknikës nga DRP në Pejë

ii. **Nga Ekspertiza Balistike AKF/2018-3096/2018-3062, i dt.12.11.2018** – konstatohet se nuk ka qenë e mundur të nxjerren gjurmë papilare nga pistoletë Pietro Beretta M92 FS, e kal.9x19, me nr. serik BIER 706093, e as nga çanta me mbishkrim `TriStar Mercedes Benz Paul Levesque` për krahasim

iii. **Nga Ekspertiza Balistike AKF/2018-0322 e dt. 07.11.2018-** konstatohet se në dëshmin #5, (pistoletës Pietro Beretta M92 FS) në tytën e saj ka mbetje të qitjes me armë zjarri me prejardhje të barotit

iv. **Nga Ekspertiza Balistike AKF/2018-0396/2018-3061 e dt. 12.11.2018-** konstatohet se nga pistoletë Pietro Beretta M92 FS, e kal.9x19, nuk ka qenë e mundur të nxirren gjurmë papilare

v. **Nga Raporti i Autopsis MA 18-293, i dt. 01.03.2019 të Departamentit të Mjekësis Ligjore në Prishtinë** – Konstatohet se vdekja e të dëmtuarit Agonis Tetaj ka ardhur si rezultat i gjakderdhjes së jashtme dhe gjakderdhjes së cipave të buta të trurit dhe trurit të vogël, si pasojë e veprimit dinamik të predhës së hedhur nga arma e zjarrit

vi. **Nga Raporti i Institutit të Psikiatris Forenzike në Prishtinë** i dt.01.03.2019 – konstatohet se i pandehuri Shaban Gogaj në kohën e kryerjes së veprës penale **nuk ka vuajtur nga ndonjë çrregullim psiqik**

vii. **Nga Përgjigjësja e AKF –Departamentit i Traseologjis Forenzike me nr Ref. AKF/2019 – 72, i dt.11.04.2019,** - vërtetohet se i pandehuri Shaban Gogaj ka njohuri shumë të mirë për armë dhe për pesë rregullat e arta të veprimit me armë



Vlerësimi mbi provat nga ana e Prokuroris

↓ Nuk është kontestuese se ditën kritike i pandehuri Shaban merr një telefonat nga vajza e hallës së tijë, Natyra Melaj, rreth ores 11.00min, gjatë bisedës me të njejtën, sjelljet e tijë ndryshojn, vërehet se viktimja, Agonisi largohet menjëherë në drejtim të stogjeve, në largësi rreth 4.70m, përballë banakut, të njejtën gjë e bëjnë edhe dy të dëmtuarit Azgon Hadërkhonaj e Faruk Zukaj, i pandehuri pasi e përfundon bisedën në fjalë, nga karriga në skajin e majtë të banakut ku ishte i ulur, ngritet duke bërë një grimace të çuditshme në fytyrë, ulet në karrigen që gjendej në krahun e tijë të djathët, lakohet dhe hapë sirtarin e fundit, e nxjerr pistoletën Pietro Beretta M92 FS , pasi e shiqon me dorën e majt e futë në te karikatorin dhe e repeton, të gjitha veprimet i kryen nën banak, e pastaj merr në shenjë në drejtim të Agonisit, qëllon një here dhe e kthen armën menjëherë aty ku e kishte marr, e pastaj ngritet nga karriga,

Nuk është kontestuese gjithashtu se nga plaga e marr nga kjo e shtënë, i dëmtuari Agonis, pëson vdekje të menjëhershme në vend ngjarje, kjo vërtetohet nga konstatimi i vdekjes dhe Ekspertiza e Autopsis nga Departamenti i Mjekësis Ligjore në Prishtinë, konkretisht i dëmtuari merr plagë në kokë, saktë në mollëzën e djathët të fytyrës, duke depërtuar kështu predha nëpër kockën zigomatike (mollëzën e fytyrës), kalon nëpër nofullën e sipërme të djathët, vazhdon nëpër indet e buta të qafës dhe nën bazën e kafkes, duke përfunduar në pjesën e pasme të qafës, mu në mesin e saj si vrimë dalëse, me ç`rast shkaktohet gjakderdhja e jashtme dhe gjakderdhja në cipat e buta të trurit dhe të trurit të vogël, si rrjedhojë i dëmtuari Agonis pëson vdekje të menjëhershme.

Të gjithë punëtorët e kësaj Kompanie, në cilësi të dëshmitarëve deklarojnë se nuk janë në dijeni për raportet mes viktimës edhe të pandehurit jashtë Kompanis, përderi sa disa flasin për raporte të mira në punë apo se nuk dinë për ndonjë problem mes tyre, por sa i përket familjarëve të viktimës, të njejtit dëshmojnë, sidomos nëna e Agonisit, se *sjelljet e të njejtit kanë ndryshuar ekstremisht kohët e fundit para se të ndodhë rasti, nga një djalë i cili ka qenë i hareshëm plotë jetë, punëtor i pashembullt, është tërhequr në vete, ka filluar të mos qëndroj fare në shtëpi, ose gjatë gjithë kohës të flej, deri sa më në fund e ka informuar se do ta lëshoj punën, vëllau i tij Dionisi dëshmon se, ta ketë dëgjuar të njejtin se si ankohet në të pandehurin, sikurse edhe dëshmitari Selmon Tetaj,*

Prokuroria ka marr informata joformale se i pandehuri Shaban ka marr ditën kritike një të dhënë nga Natyra lidhur me Agonisin, por të cilat nuk ka mund t'i vërtetoj me asnjë provë, sepse logjikisht vetëm këta dy e din se çfar kanë folur atë ditë në telefon, deri sa Natyra thot të kenë folur për dalje në Bjeshk, e të ngjashme, Shabani thotë se *`nuk i kujtohet çka kanë biseduar...`*

Po ashtu kemi pranuar informata se i pandehuri i ka vizituar poligonet e qitjes rregullisht, dhe se i pëlqejn shumë armët dhe ka njohuri të madhe mbi to, mirëpo policia nuk ka gjetë në regjistra e poligoneve në regjion, të regjistruar emrin e tijë.

Duke parë veprimet me armë të të pandehurit Shaban ditën kritike, ka lënë përshtypje që i njëjti me të vërtetë ka njohuri për armë dhe i njëj mirë ato, andaj është kërkuar nga ekspertët e Agjencionit të Forenzikës në Prishtinë, konkretisht Departamenti i Traseologjis Forenzike, që në bazë të videoinçizimit të ditës kritike, dhe veprimeve të të pandehurit në fjalë në lidhje me armën, të japin mendimin se a kemi të bëjmë me person që din të veproj me armë zjarri apo jo.

Nga Përgjigjësja zyrtare e tyre, Konstatohet se (*cit.*) *``I pandehuri ka pasur njohuri paraprake lidhur me përdorimin e armës së zjarrit, konstatim ky që bazohet në ato se: veprimet e mbushjes me karikator, repetimi dhe veprimi pas gjuajtjes, janë në përputhje për përdorim të drejtë dhe të sigurtë të armës së zjarrit, kurse veprimi i shënjestrimit dhe gjuajtjes janë në përputhje me rregullat dhe komponentët e shënjestrës, Të gjitha veprimet e operimit me armë të zjarrit dhe shënjestrimit nga ana e gjuajtësit, janë përdorur sipas rregullave kryesore për përdorim të sigurtë të armës së zjarrit dhe rregullat për shënjestrim në cak. Këto veprime të operimit parashihen si rregullat e arta për përdorimin e armëve të zjarrit``*

Është konstatuar se këto dy armë në dukje nuk ngjajn as përafërsisht, qoft për nga forma qoft për nga ngjyra, arma me gazë është e ngjyrës së zezë, deri sa arma me të cilën është shtën është ngjyrë bronzë e qelët

Rjedhimisht nuk qëndrojnë pretendimet e të pandehurit se nuk ka njohuri për armë zjaeri, e sidomos se i njëjti ka ***menduar se po shtien me armë gazi...***

Në anën tjetër, është shumë e dyshimt për Prokurorin se ditën kritike, si erdhi pistoleta me gazë e tipit Blow TR 92 e kalibrit 9 mm, 15 – 1306191 në çantën me mbishkrim *``TriStar Mercedes Benz Paul Levesque``* në të njëjtin sirtar me armën me të cilën është kryer vepra, pasi që që të gjithë dëshmitarët, punëtor të kësaj Kompanie flasin se kanë qenë në dijeni të ekzistimit të vetëm një arme, për më tepër familjarët e të pandehurit, si Florentina Melaj e Natyra Melaj, kjo e fundit i referohet *``një arme me leje``*

Deri sa i pandehuri Isuf, edhe pse thotë t'i ketë takuar atij kjo armë me gazë, ai nuk din të thotë se ku e nga kush e ka blerë, kur saktësisht e ka blerë, çfarë është shumë e habitshme, se çfarë tipi i armës është....

Nga veprimet e policëve, në veçanti të Stacionit Policor në Deçan ditën kritike pas rastit, të cilët shifen se si gjurmojnë në sirtarin ku është gjetë arma me të cilën është kryer vepra, sikurse edhe personave civil, lënë shumë për të dyshuar se ka pasur mundësi të manipulimit me prova, sidomos kur edhe Krim Teknika ka gjetë fillimisht vetëm një armë dhe ate me të cilën është kryer vepra, deri sa më vonë dikush nga policët i ka informuar se aty gjendet edhe një armë me gazë...duke pasur parasysh se arma me gaz ka qenë e futur në një çant, si ka pasur mundësi të dijn policët se në atë çant është kjo armë.dhe ate me gaz..

Për këto rrethana i mbetet Prokuroris që të hetoj tutje

Po ashtu gjatë hetimeve kemi marr informata se Dr.psik. Muhamet Halitaj, i cili gjatë vizitës në Qendrën e Paraburgimit në Pejë, është kërkuar nga që i pandehuri Shaban urgjentisht të vizitohet nga Instituti i Psikiatris Forenzike në Prishtinë, edhe pse askush

nga stafi i kësaj Qendre nuk ka vërejtur në sjelljet e të pandehurit ndonjë ndryshim apo të jetë ankuar i njejt, sikurse që edhe vet Dr. Halitaj e pranon se i pandehuri nuk ka qenë në listë të të paraburgosurve për tu kontrolluar tek ai, se i pandehuri nga anamneza që i ka bërë, nuk ka vuajtur asnjëherë më parë nga ndonjë sëmundje apo çrregullim mendor, por se thotë të ketë *prirje tani për vetvrasje*

Prokuroria megjithate ka urdhëruar një egzaminim psikiatrik në Institutin në fjalë, nga Raporti i të cilit rezulton se *i pandehur në kohën e kryerjes së veprës penale, nuk ka vuajtur nga ndonjë çrregullim mendor e as para rastit*

Nga të dhënat e kësaj Prokurorie dhe Gjykatës Themelore në Pejë për të pandehurin Shaban, rrjedh se ndaj të njejtit si i mitur 17 veçar, i është shqiptuar Masë Edukative për shkak të lëndimeve që i ka shkaktuar Leonis Kuqit nga Deçani, me Aktvendim PM nr. 6/18, të dt. 09.08.2018

↓ **Sa i përket pikës së II-të** për të pandehurin Shaban dhe **pikës së III-të** të kësaj Aktakuze, konsiderojm se është vërtetuar nga provat e cekura se i pandehuri Shaban ka mbajtur në posedim armën e tipit Pietro Beretta M92 FS, pa leje të organeve kompetente, sikurse i pandehuri Isuf në pronësi pistoletën e tipit Blow TR 92, në kundërshtim me Ligjin mbi armët

Prokuroria në prezencën e të gjitha këtyre dëshmimeve e provave direkte dhe rrethore, sa i përket edhe Pikës së I –rë të kësaj Aktakuze, konsideron se është vërtetuar përtej çdo dyshimi të bazuar mirë se i pandehuri Shaban e ka kryer veprën penale në fjalë

PROKURORI I SHETIT

Sahide Gashi

